VENDIM
Nr. 169, datë 18.12.2012

PËR MIRATIMIN E SKEMËS SË PËRLLOGARITJES SË KAPACITETIT TOTAL TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe pikës 4, paragrafi i parë i "Rregullave të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi miratimin e skemës së përllogaritjes së kapacitetit total të transmetimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Procedura që ndiqet nga ana e shoqërisë OST sh.a. dhe nga çdo TSO e rajonit, bazuar në udhëzuesin operacional të ENTSO-e, për llogaritjen e kapaciteteve transmetuese ndërkufitarë është si më poshtë:

- 10 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen të dhënat, modeli nacional me të gjitha nyjet e nivelit 220/400 kV, ndërmjet TSO-ve, në formatin e aprovuar UCT, përfshirë rezervën e fuqisë aktive për rritjen/uljen e gjenerimit, dhe të dhëna mbi programin e remonteve (elementet jashtë pune) për periudhën e konsideruar;
- 5 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, kryhen llogaritjet (simulimet) për vlerat e TTC/NTC që rezultojnë nga plotësimi i kriterit N-1 të zbatuar për çdo zonë kontrolli;
- 2 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen vlerat e përcaktuara të TTC për çdo kufi, dhe fillon procesi i harmonizimit të tyre. Në rast mospërputhjeje të vlerave të llogaritura, dhe nëse palët nuk arrijnë të bindin njëra-tjetrën, atëherë vlera më e vogël e TTC hyn automatikisht në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e përllogaritjes së kapacitetit total të transmetimit (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani